



ME RASTIN E NDËRRIMIT TË MOTMOTEVERE

Të nderuar të punësuar;

Më lejoni të filloj me një përshëndetje për të gjithë juve për performancën e shquar në këtë vit. Jam personalisht i impresionuar me përpjekjet që janë bërë në përmirësimin e dosjeve të sigurisë dhe ambientit të punës. Duke arritur më shumë se 600,000 tona shitje, është numër që unë e ëndërroja në fillim të vitit. Gjithashtu prodhimi ka bërë një hap të madh përpara duke e mbështetur shitjen përgjatë tërë vitit. Duke shikuar prapa, mund të ndaj me ju kënaqësinë time të madhe që i kemi implementuar aksionet e hershme për të përmirësuar kostot tona të prodhimit dhe rritjen e çmimeve tona. Ne i kemi arritur apo madje i kemi tejkaluar objektivat tona të vendosura për vitin 2009. Nuk është më sekret se do ta përfundojmë vitin 2009 si një vit i ri rekord për Sharrcemin.

Përpos dosjeve të shkëlqyeshme të sigurisë dhe performancës financiare, unë gjithashtu do të doja të përmendi që Sharrcemi është njohur edhe një herë si njëri nga tatim paguesit më të mirë në Kosovë dhe është shpërblyer

me Çmimin FIDES, çmim për kontributin aq të madh tek komuniteti lokal dhe të punësuarit e saj. Në përmbledhje, guxoj të them se, Sharrcemi qëndron më fort tani se një vit më parë. Më lejoni të ju bëj një falënderim të madh për të gjithë juve për kontributin tuaj duke mundësuar që kjo të bëhet realitet.

Pas vitit të shkëlqyeshëm 2009, siç duket do të ballafaqohemi në vitin 2010 me më shumë kërkesa. Për ta mbajtur këtë margjinë do të jetë "sfidë"; duhet ta mbajmë këtë duke mos zhgënjyer arritjet tona në anën kushtuese dhe duke qëndruar konkurrues në treg. Unë akoma shoh mundësi për ti shërbyer klientëve tanë më mirë duke implementuar ide kreative gjithashtu edhe inovacione të produkteve dhe shërbimeve.

Në përmbyllje, do të doja të ju falënderoj përsëri për përpjekjet e jashtëzakonshme të ndërmarra në vitin 2009, duke ju dëshiruar juve dhe familjeve tuaja të gjitha të mirat, shëndet dhe lumturi për vitin 2010.

Më përshëndetjet më të mira
Patrick Stapfer



Në këtë numër

- ▶ Shiten mbi 600.000 tonë
- ▶ Takimet dhe pas takimeve
- ▶ Sharrcem organizon darkën e fundvitit
- ▶ Sharrcem për komunitetin
- ▶ Dhuratat për fëmijë Për vitin e ri 2010
- ▶ Numër i konsideruar i Punëtorëve në pushim

REKORD HISTORIK NE SHITJEN
E PRODUKTEVE TE SHARRCEM
GJATE VITIT 2009

SHITEN MBI 600.000 TONË



Kompania SHARRCEM gjate vitit afarist 2009, arriti qe ne tërësi t`i realizon me sukses të gjitha planet e shitjes së produkteve të veta dhe në sasi të konsideruar këto plane edhe t`i tejkalon.

Sasirat e përcjelljes së të gjitha llojeve të çimentos dhe sharmallit në drejtim të tregut kosovar, në fund të vitit 2009, arritën shumën e mbi 600.000 tonelata, sasi e cila nuk ishte arritur asnjëherë gjatë këtyre gati dhjetë vjetëve të ekzistimit dhe punës së kompanisë SHARRCEM dhe në asnjë herë në historinë e fabrikës Sharr në gati shtatë dekada.

Pjesë e arritjes së këtij sukcesi në shitjen e produkteve, pamëdyshje se janë të gjithë punëtorët

e kësaj kompanie duke filluar që nga Ekipi Menaxhues e deri të menaxherët, drejtuesit dhe organizatorët tjerë e deri te çdo punëtor veç e veç. Dhe për këtë nuk ka pse të mos jenë krenar që të gjithë.

NË VEND TË KOMENTIT

TAKIMET DHE PAS TAKIMEVE

Për veç formave dhe qasjeve të reja nga e kaluara, kompania SHARRCEM ka disa vite që gjatë fundvitit afarist organizon me sukses takime të rregullta me të gjitha kompanitë apo biznese që në aktivitetet e tyre kanë edhe përdorimin dhe shitjen e llojeve të çimentos dhe sharmallit, produkte të cilat SHARRCEM ofron këtij tregu.

Edhe takimet e sivjetshme, që u organizuan shumë mirë nga Departamenti i Shitjes e Marketingut, kishin arritur efektet e dëshiruara si për kompaninë SHARRCEM poashtu edhe për blerësit e saj.

“Është e vërtetë se edhe këto takime përfunduan me sukses, thotë menaxheri i



Dep. të Shitjes e Marketingut z. Naxhid Raka, duke shtuar se pjesëmarrja e blerësve tanë ishte maksimale dhe përmbytësore që në shumë raste shprehej një kënaqësi për këtë transparencë cilësore. Nga kompania jonë u ofruan të gjitha ato të dhëna rreth aktivitetit tonë në këtë vit dhe për të gjitha ato synime për vitin e ardhshëm.”

Takimet me blerës, sipas përfaqësuesve të kompanive dhe bizneseve, pos tjerash janë edhe një respekt që SHARRCEM tregon ndaj parterëve të vet afarist. Dhe kjo është ndoshta edhe e veçanta e këtyre takimeve, e cila jo se mund t`a gjejmë te kompanitë tjera me ndonjë përjashtim.

Dhe krejt në fund. Është konkludim si i kompanisë SHARRCEM poashtu edhe i blerësve se kjo formë e mbajtjes së kontakteve, kjo transparencë dhe besim reciprok i krijuar, është një përvojë e mirë që fundja edhe tregon se rrugëtimi i përbashkët do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

PËR HERË TË PARË

SHARRCEM ORGANIZON DARKËN E FUNDVITIT

Në javën e tretë të muajit dhjetor 2009, kompania SHARRCEM, për herë të parë organizoi një darkë për të gjithë punëtorët e vet, darkë siç u quajt "DARKA E FUNDVITIT".

Në një atmosferë vërtet të këndshme dhe në një mënyrë festive që i shkonte mirë edhe ditëve të para festave të fundvitit dhe përfundimit edhe të një viti të suksesshëm, zhvilloheshin biseda të llojllojshme, momente dhe ndodhi të ndryshme që kishin ndodhur gjatë vitit 2009 nëpër vija të ndryshme teknologjike apo objekte dhe aktivitete të ndryshme.

Në një moment të përshtatshëm, punëtorëve ju drejtua me disa fjalë edhe vet ZKE i kompanisë



SHARRCEM, z. Patrick Stapfer, duke thanë se "SHARRCEM, ka përmbyllur edhe një viti të suksesshëm dhe atë më të suksesshmin në historinë e kësaj fabrike duke i realizuar që të gjitha synimet dhe planet e veta edhe pse në fillim të vitit për shkak të kushteve atmosferike kishin disa ngecje. Por që më pas ato u tejkaluan në tërësi.

Atmosfera e mirë gjatë darkës, arriti të kulmon gjatë shpalljes së fitueseve të dhuratave, që u realizua me një lloje tombolle, ku secili punëtor në ftesën e vet për këtë darkë kishte të regjistruar edhe një numër përkatës. Nga kjo lojë, përfituan disa punëtorë të cilët fituan mbajtëse të lapsave me orë digjitale, një çantë udhëtimi, një aparat fotografik digjital dhe fituesi i fundit fitoi një Laptop.

Në fund të konkludojmë besoj me të drejtë se organizimi i kësaj "DREKA E FUNDVITIT", jo vetëm se ishte vërtetë e organizuar mirë dhe shumë e pëlqyer nga të gjithë, por fundja tregoi edhe një herë qasjen e re të kompanisë për të gjitha format dhe aktivitetet e punëtorëve brenda për brenda të kompanisë, respektin reciprok dhe besimin e ndërsjellë. Ishte vërtetë një ngjarje e mirë dhe për t' u mbajtur mend.

SHARRCEM PËR KOMUNITETIN

Edhe gjatë këtij fundviti, kompania SHARRCEM, vendosi që të jetë mbështetëse në ofrimin e ndihmave financiare e materiale për subjekte të ndryshme në kulturë, shëndetësi dhe infrastrukturë.

Përfitues kësaj here të kësaj mbështetje ishin Shoqëria Kulturo Artistike "Gryka e Kaçanikut" në Kaçanik me 300.00 euro, Qendra Familjare e Shëndetësisë "Dr. Menduh Kaloshi" në Han të Elezit me 1.000 euro si dhe lagjja e Re "RANA" nga fshati Bush në Han të Elezit me 75 tonelata çimento për ndërtimin e urës që lidh këtë lagje me pjesën tjetër të Hanit të Elezit.



NGA SHARRCEM;

DHURATAT PËR FËMIJË PËR VITIN E RI 2010



Edhe për këtë vit të Ri 2010, kompania SHARRCEM, nuk i harroi dhuratat për fëmijët e të gjithë punëtorëve të vet, fëmijët e skamnorëve, të invalidëve të luftës, OJQ-së "HENDIKOS" si dhe fëmijëve të punëtorëve shëndetësor në Qendrën Familjare të Shëndetësisë në Han të Elezit.

Këto dhurata si edhe ato gjatë viteve të tjera, do të krijojnë një moment të hareshëm dhe të lumtur për të gjithë ata fëmijë me rastin e pritjes dhe festimit të Vitit të Ri 2010. Pra, fëmijë të dashur Gëzuar Viti i Ri 2010 dhe shumë gëzime dhe çaste të lumtura në familjet e Juaja.

PËR SHKAK TË SEZONIT DIMËROR

NUMËR I KONSIDERUAR I PUNËTORËVE NË PUSHIM

Zvogëlimi i nevojës për angazhimin e punëtorëve në procesin e punës për shkak të sezonit dimëror, ishte edhe arsyeja kryesore e dërgimit të punëtorëve në pushim vjetor për ata që kanë ditë pune të pashfrytëzuar për vitin 2009 dhe nga 4 ditë pushim vjetor për vitin 2010 për punëtorët tjerë.

Pushimi në fjalë fillon nga 21 Dhjetori 2009 e gjer më 4 janar 2010.

Gjatë kësaj periudhe kohore, do të punojnë vetëm punëtorët të cilët patjetër duhet të jenë prezent në punë, sipas urdhëresës së udhëheqësve të tyre të drejtpërdrejtë.



Imbajnië premtimet!
SHARRCEM